



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:148293

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05753534

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari Driton Sadiku, me bashkëpunëtorin profesional Sefedin Avdijaj, në lëndën penale ndaj të pandehurit A. M. nga Gjakova, si dhe të pandehurit K. B. nga fshati Rr, Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë në bashkëkryerje nga neni 321 par.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në vazhdim KPRK-së), të akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm sipas aktakuzës me numër PP/II.nr.591/2023 të datës 22.05.2024, duke vendosur lidhur me propozimin e prokurorisë për dhënien e urdhrin ndëshkimor, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datën 29.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti Përgjithshëm, për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP/II.nr.591/2023 të datës 22.05.2024, gjykata ne kuptim të nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale (në vazhdim KPP-së), jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Të pandehurit:

1. A. M., nga i ati A, e ëma L, vajzërisë M, data e lindjes . . . , në Gjakovë, ku edhe tani banon në rr.”. . . p.n, i pa martuar, i pa shkolluar, i gjendjes së dobët ekonomike, ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal . . .

2. K. B., nga i ati S, e ëma H, vajzërisë G, data e lindjes . . . , në Gjakovë, ku edhe tani banon në fshatin Rr, i martuar, ka të kryer shkollën fillore, bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal . . .

J A N Ë F A J T O R

Sepse më datën 18.04.2023, rreth orës 11:00/h, në fshatin Rr, Komuna e Gjakovë, konkretisht në vendin e quajtur “Prroni i zi” me dashje dhe në bashkëveprim me njëri tjetrin e dëmtojnë pasurinë e tjetrit këtu të dëmtuarit L. Xh., në atë mënyrë që ditën kritike të pandehurit i dërgojnë rreth 60 krerë bagëti-dhi për t’i kullosor, ku fillimisht të dëmtuarit ia dëmtojnë telat me xhamba që ka qenë e rrethuar prona - livadhi e më pas i futin bagëtitë për kullosje në livadhin e të dëmtuarit edhe pse i njëjti iu kishte tërhequr disa herë vërejtën, me ç’rast të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm material.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë në bashkëkryerje nga neni 321 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 4, 38, 40 par.1 pika 1.3, 43, 69, 70 dhe 321 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPP-së, të pandehurve iu;

S H Q I P T O N

- I. Të pandehurit A. M., DËNIM ME GJOBË në shumë prej njëqindpesëdhjetë (150.00) euro, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Të pandehurit K. B., DËNIM ME GJOBË në shumë prej njëqindpesëdhjetë (150.00) euro, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Nëse të pandehurit nuk dëshirojnë ose nuk mund ta paguajnë dënimin me gjobë, atëherë të pandehurve dënimi me gjobë iu zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej shtatë (7) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga njëzet (20.00) euro.

- IV. I dëmtuari L. Xh. nga fshati Rr., Komuna e Gjakovës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.
- V. Detyrohen të pandehurit që t'i paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej njëzet (20.00) euro secili veç e veç, si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzet (20.00) euro secili veç e veç, të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë–Departamenti Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka parashtruar aktakuzën me numër PP/II.nr.591/2023 të datës 22.05.2024, ndaj të pandehurve A. M. dhe K. B., për shkak të veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë në bashkëkryerje nga neni 321 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimorë, duke i propozuar gjykatës që të pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, dhe të pandehurve të ju shqiptoj dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme se të pandehurit i kanë kryer veprat penale të cila iu vihen në barrë.

Pas shikimit të shkresave të lëndës dhe provave që gjinden në shkresat e lëndës, gjyqtari i vetëm gjykues gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 par.1 të KPP-së dhe në kuptim të nenit 495 par.1 të KPP-së vendosi që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: raporti i policit L.S., i datës 18.04.2023; deklarata e të dëmtuarit L. Xh., e dhënë në polici me datën 18.04.2023; deklarata e pandehurit A. M., e dhënë në polici me datën 25.04.2023; deklarata e të pandehurit K. B., e dhënë në polici me datën 18.04.2023; si dhe fotografitë e vendit të ngjarjes, janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtin do të arrihet qëllimi i dënimit në vështrim të nenit 38 të KPP-së, që të parandaloj kryerësit nga kryerja e veprës penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, që në të ardhmen të pandehurit të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpërsojë dënimin kundër tij,

po ashtu të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe me këtë dënim të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe të ngritë moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë duke u bazuar në nenin 462 par.2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë në bazë nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 452 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit në bazë të nenit 36 par. 3 nënpar.3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
2024:148293, më datën 29.05.2024

Bashkëpunëtori profesional,
Sefedin Avdijaj

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Driton Sadiku

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre mund të ushtrojnë kundërshtim në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të tij, kundërshtimi paraqitet në këtë gjykatë. Nëse nuk ushtrohet kundërshtim brenda afatit të përcaktuar, aktgjykimi do të merr formë të prerë dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.